



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 590/2024
Data: 22.01.2024

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e dymbëdhjetë -XII- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 28.12.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Lindita Ballazhi** (Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Natyra Kalisi** (Drejtoreshë e Administratës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsime, Kulturë, Rini dhe Sport), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Rezart Mehmeti** (Përfaqësues i OSB-së), Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024.
3. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi 2024.
4. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2024.
5. Draft plani lokal i veprimtimit për Barazi Gjinore.
6. Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2023/2027.
7. Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi.
8. Raporti i planit të integritetit për vitin 2023.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- përveç pikave të rendit të punës, ua kemi përcjellë edhe dy materiale shitesë që na i ka përcjell ekzekutivi i komunës, propozim vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr.9696/2021 pra bëhet fjalë për përbërjen e Komitetit për Politikë e Financa, propozim vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr.469/2012 pra bëhet fjalë për rritjen e shpenzimeve të varrimit, për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- është kërkesë nga Bashkësia Islame – dega në Han të Elezit për rritjen e shpenzimeve të varrimit por nuk është e lehtë për me i rritë shpenzimet dhe si kërkesë e kam pranuar dhe propozim vendimin e kam përcjell për Kuvend. Shuma e cila është propozuar është nga 170 € në 250 €. Si pikë tjetër është draft raporti i auditimit social nga Birni për disa rekomandime të cilat i kanë dhënë te projekti i parkut "Isa Berisha". Këtë auditim e kemi pranuar për shkak se është një lloj katalizatori i rregullave që na duam me dal pak më mirë. Prezent është edhe përfaqësuesi i Birnit. Është vetëm draft raport dhe vetëm është për me u diskutuar dhe kërkoj që të hynë si pikë e rendit të punës.

Kryesuesi thekson:- kërkesa për raportin e auditimit social është dërguar me vonesë pasi e kemi dërguar materialin për kuvend por do të votohet secila pikë një nga një.

Sherif Berisha thekson:- pasi u propozuan tri pika të reja për me hyjë në rend të punës kërkoj një pauzë prej pesë minutave që të konsultohemi si shefa të grupeve parlamentare.

Kryesuesi thekson:-pas konsultave me shefat e grupeve parlamentare pikat shtesë do të votohen veç e veç. Propozim vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr.9696/2021 e hedh ne votim, rezultati i votimit ishte njëzëri. Propozim vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr.469/2012 e hedh ne votim, rezultati i votimit ishte njëzëri. Raportin e auditimit e hedh ne votim, rezultati i votimit ishte 3 abstenim, 11 kundër, do të thotë kjo pikë e rendit të punës mbetet me u diskutuar për seancën e radhës. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës, rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024.
3. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi 2024.
4. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2024.
5. Draft plani lokal i veprimtimit për Barazi Gjinore .
6. Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2023/2027.
7. Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi.
8. Raporti i planit të integritetit për vitin 2023.
9. Propozim vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr.9696/2021.
10. Propozim vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr.469/2012.
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Sherif Berisha thekson:- çështja e ujit është një problem i cili ka vazhduar dhe po vazhdon dhe nuk po i shihet fundi që po përfundon. Nga materiali që shihet nuk shohë diçka konkretë për këtë çështje që do të ndërmerret. Siç jeni të informuar nga muaji janar do të fillohet me pagesë të ujit dhe ne e dimë që uji nëpër shtëpitë tona po vjen jo i pishëm dhe nuk e di a është në rregull me paguar ujë që nuk është i pishëm. Nëpër drejtori siç e kam parë materialin ne kemi votuar buxhet tjetër dhe projektet janë tjera. Punët shtesë të cilat shtohen nuk e di me çfarë procedura bëhen.

Zaim Bela thekson:- plani i punës bëhet duke u bazuar në buxhetin që është miratuar për vitin 2024 dhe unë kam qenë kundër por unë kam edhe disa vërejtje dhe nuk e shohë të arsyeshme që ta votoj planin e punës.

Mehmet Ballazhi thekson:- planin dhe projektet nuk kanë ndryshuar dhe nëse planifikohet diçka nuk do të thotë që ka me u realizuar sepse edhe nëse duam por nuk mundemi për shkak të mundësive buxhetore. Nëse nuk e ke votuar buxhetin e komunës nuk do të thotë që ka ndonjë problem sepse e kanë votuar tjerët dhe me bërë planin edhe dy fish më shumë nuk do thotë që kemi me realizuar. Edhe nëse nuk e votoni planin ne kemi me funksionuar sepse nuk mundemi pa plan me funksionuar e sa realizohet mandej duhet të jeni të kujdesshëm për me përcjell planin e punës së Kryetarit të Komunës në raport me buxhetin dhe procedurat. Në këtë plan nuk ka vetëm projekte por ka subvencione dhe planifikime tjera por nëse ka konkrete diçka mund të propozoni. Sa i përket çështjes së ujit ditën e martë ja kemi kaluar në pronësi kompanisë “Bifurkacioni” çështjen e fabrikës për përpunimin e ujit dhe kjo ka qenë puna më e vështirë për me bërë dhe me ja kaluar në përgjegjësi atyre dhe nuk kërkohet në këtë formë me u zgjidhur problemi i ujit por zgjidhet duke bashkëpunuar dhe jemi duke i kryer punët tona për aq sa kemi mundësi dhe aq sa na lejohe.

Sherif Berisha thekson:- unë nuk mundem me u pajtuar me konstatimin tënd që ekzekutivi nuk ka përgjegjësi së bashku me ju, pra nuk qëndron sepse duhet me pasur ujë dhe pajtohem se ndoshta ka probleme të ndryshme por duhet të ndërmerren masa sepse nuk e dimë se si mund të paguajnë qytetarët ujë jo të pishëm.

Mehmet Ballazhi thekson:- askush nuk po të thotë që me paguar sepse nëse ke të drejtë mos me paguar mos e paguaj është çështje jote sepse nuk jemi ne për këtë punë ka të tjerë që merren se a duhesh me paguar apo jo. Për me menaxhuar ujin ligjore është kompania “Bifurkacioni” nuk është çështje e jona se ne ja kemi ofruar asetet dhe është çështje e secilit se a paguan ujë apo jo dhe nuk i dimë masat që mund t’i ndërmerr kompania “Bifurkacioni”.

Resul Suma thekson:- potencuat që i keni dorëzuar asetet të kompania “Bifurkacioni” por përveç lajmeve që i ka pa nuk kam parë ndonjë informacion prej komunës që prej muajit dhjetorë do të hynë në pagesë, a keni informacion për çështje të pagesë së çështjes së ujit.

Mehmet Ballazhi thekson:- ajo që ka qenë në kompetencë të komunës ka qenë që me ja përgatitur atë impiantë të ujit të kompletuar për menaxhim për përpunim të ujit, ndërsa procedurat tjera janë të kompanisë për atë ideja ka qenë që në mënyrë mediale me dorëzuar si informacion për qytetarët që adresa për shumë pyetje është te kompania “Bifurkacioni”. Faturat për shpenzime të ujit nuk i kemi si informacion.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 13 për, 1 abstenim.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2024

3. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- materialin e keni para vetës dhe i kemi zgjedhur disa tema që duhet të trajtohen gjatë vitit të ardhshëm. Nëse keni ndonjë propozim që mendoni që duhet të jetë në plan të punës mund të parashtroni.

Hyrijete Isufi thekson:- parandalimi i sjelljeve devijante të rinjtë më pëlqen si aktivitet por nuk po shohë që ka ndonjë objektivë por periudha kohore është në vazhdimësi, rezultati shoqëri pa dhunë është në rregull por disa herë e kam diskutuar sepse dyshoj te ushqimet dhe pijet është mirë me shikuar sepse është diçka që fëmijët po i bënë të dhunshëm.

Mehmet Ballazhi thekson:- vetë tema është objektive dhe nuk mundesh në këtë rast me u përkufizuar me një qëllim të caktuar apo me një pikë të vetme sepse vetë tema e parandalimit të sjelljeve deviate te të rinjtë ka shumë për me diskutuar, për dukuritë negative dhe tema të shumta.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI I KSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI 2024

4. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2024

5. Draft plani lokal i veprimit për Barazi Gjinore .

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE

6. Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2023/2027.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mjlinda Kaloshi thekson:-dokumenti i strategjisë për zhvillim ekonomik 2023/2027 ju ka nënshtruar të gjitha procedurave ligjore, është shqyrtuar në Komitet për Politikë e Financa , Kuvend të Komunës dhe në debat publik, ndërsa sot procedura e miratimit. Nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK 2023/2027

7. Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam por për shkak të procedurave që i kemi me shoqatën Islamik Relief Kosova me të cilën i kemi ndarë 84 serra. Numri i përfituesve në komunën tonë nga buxheti i komunës dhe shoqatat e ndryshme është 157 përfitues.

Zaim Bela thekson:- subvencionet në mënyrë linear, dikush ka pasur perime deri në dhjetë ari dhe ju janë ndarë 200 €, dikush më shumë dhe janë subvencionuar njëjtë. Serrat a do të montohen në këtë vit apo në vitin e ardhshëm.

Abduraman Bushi thekson:- pagesat lineare është bërë në atë formë për shkak të obligimeve financiare që i kemi pasur me shoqatën Islamik Relief sepse nuk është njëjtë sikur pesë ari sikur dhjetë ari por për shkak të mundësive buxhetore e kemi ndarë në atë formë. Montimi i serrave ka filluar dhe deri më tani janë montuar njëzet serra.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

7. Raporti i planit të integritetit për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

8. Propozim vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr.9696/2021.

Kryesuesi thekson:- bëhet fjalë për përbërjen e Komitetit për Politikë e Financa që në vend të znj.Ibadete Kalisi do të jetë z.Xhevahir Dernjani dhe në vend të z.Refet Kalisi do të jetë znj.Hyriete Isufi për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NUMËR 01/Nr.9696/2021

9. Propozim vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr.469/2012.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:-kjo kërkesë ka qenë edhe më e hershme por duke i parë parasysh çmimet që janë rritur dhe shuma prej 250 € mendoj që nuk është e madhe. A ka informacion dikush për varrezat se a janë të fshatit Neqafçë apo edhe të Hanit të Elezit.

Mehmet Ballazhi thekson:- po të kishim mundësi do ta propozonim 300 € apo 400 € për shkak se janë të nevojshme dhe e meritojnë por këto janë mundësitë buxhetore. E di që janë një parë varreza të qytet dhe për atë që parashtuat pyetje nuk kam informacione edhe pse është temë tjetër dhe ndoshta mund ta pyesim bashkësinë islam se si e kanë përcaktuar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NUMËR 01/NR.9696/2021

6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nora Xhoni thekson:- kërkoj informacion për çështjen e bredhit para komunës.

Mehmet Ballazhi thekson:- është çështje e policisë sepse janë duke i zhvilluar hetimet për shkak se ata janë përgjegjës.

Erblin Meliqi thekson:- e përgëzoj drejtorin për bujqësi pylltari dhe zhvillim rural për subvencionime serra për 84 fermer. Po ashtu e përgëzoj për aksionin për mbjelljen e fidaneve të pishave në kodrën e fshatit Seçishtë.

Xhevahir Dernjani thekson:- projektet e përfunduara dhe ata të cilat vazhdojnë në vitin 2024 janë zhvilluar sipas kodeve dhe pikave të projekteve në gjithë qytetin e Hanit të Elezit dhe fshatrat për rreth të cilat i kemi. Për vitin 2024 shpresojmë që këto projekte të kryhen në afate të cilat kërkohen.

Hanumshahe Dibrani thekson:- kërkoj sqarim nga drejtorja e arsimit për shujtat e nxënësve të cilët ju kanë ndërprerë. A ka pasur drejtorja e administratës ndonjë takim me administratorët e fshatrave.

Hisni Luri thekson:- shujtat nuk janë ndërprerë por është shpenzuar kodi që ka qenë i caktuar për shujta dhe nuk kemi pasur mjete të dedikuara enkas për shujtat e nxënësve, nëse Ministria ndanë mjete përsëri për shujta do t'i ekzekutojmë.

Natyra Kalisi thekson:- prej që janë ndaluar mëditjet për këshillat lokale nuk kemi pasur takime dhe ata këshilla që kanë pasur interesim me u takuar vazhdimisht mbajmë kontakte. I kemi ftuar nëpër debate publike dhe kemi pasur përgjigje pozitive prej tyre, disa kanë shkuar edhe nëpër trajnime.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:58.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

